

**V E N D I M**  
**Nr.40 datë 29.1.1993**

**PËR NDIHMË EKONOMIKE PËR ISH-TË DËNUARIT DHE TË PËRNDJEKURIT  
POLITIKË**

Në mbështetje të ligjit nr.7598, datë 1.9.1992 "Për krijimin e fondit te veçantë e monetar për ish-të denuarit dhe të përndjekurit politikë", me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë që janë trajtuar me përkrahje sociale sipas ligjit nr.7521, datë 30.10.1991 (ndryshuar me ligjin nr.7579, datë 2.7.1992), për të cilët periudha njëvjeçare e kësaj përkrahjeje ka mbaruar, të marrin ndihmë ekonomike në masën 65 për qind të pagës minimale mujore të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

2. Ndihmë ekonomike sipas pikës 1 nuk përfitojnë, kur:

a) U lind e drejta për pension, duke filluar nga data e marrjes së pensionit.

b) Hyjnë në marrëdhënie pune.

c) Marrin tokë në pronësi ose përdorim.

ç) Marrin ndihmë ekonomike nga akte të tjera nënligjore.

3. Në rastet e përmendura në pikën 2, personi duhet të kërkojë ndërprerjen e ndihmës ekonomike. Kur nuk e bën këtë, detyrohet të paguajë 10-fishin e shumës së përfituar padrejtësisht.

4. Për përballimin e kësaj pagese Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë përdor një shumë prej 7.5 milionë lekësh nga fondi i veçantë monetar për ish-të përndjekurit politikë që caktohet çdo vit si zë i veçantë në buxhetin e shtetit.

5. Kjo ndihmë do të paguhet në zyrat e punës, emigracionit, përkrahjes sociale dhe të përndjekurve politikë, duke filluar nga data e mbarimit të afatit njëvjeçar të pagesës për përkrahjen sociale.

6. Ndihma ekonomike do të paguhet për një afat prej 12 muajsh.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**